



# KONTROLLI I LARTË I SHTETIT



## 2014

viti 2014

# BULETINI

# 1

Tiranë, 2014

Adresa:  
**KONTROLI I LARTE I SHTETIT**  
Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Nr.3,  
Tiranë

Tel: ++355 (04) 251267  
Fax: ++355 (04) 232491  
E-mail: [klsh@klsh.org.al](mailto:klsh@klsh.org.al)  
[WWW.klsh.org.al](http://WWW.klsh.org.al)



**I PËRMBLEDHJA E AUDITIMEVE TË USHTRUARA GJATË PERIUDHËS  
JANAR – PRILL - 2014**

**II PASQYRAT STATISTIKORE**

Evidenca e emërimit të subjekteve të audituara nga KLSH, për të cilët janë evaduar rezultatet e auditimit.....	Formulari 1
Evidenca përmbledhëse e shkeljeve me dëm ekonomik të konstatuara gjatë auditimeve të ushtruar për të ardhurat dhe shpenzimet.....	Formulari 2
Evidenca e masave disiplinore dhe administrative të rekomanduara dhe zbatimi i tyre	Formulari 3
Evidenca e kallëzimeve penale të KLSH.....	Formulari 4
Evidenca e shqyrtimit të ankesave dhe kërkesave drejtuar KLSH.....	Formulari 5



Për periudhën janar - prill 2014, Kontrolli i Lartë i Shtetit, **nga 53 auditime të planifikuar për evadim, në fakt ka ushtruar dhe ka vijuar me përgatitjen e materialeve për 79 auditime**, nga të cilat:

- **36** janë të përfunduar e të evaduar, ku:
  - 28 janë auditime për përputhshmërinë (ligjshmëri e rregullshmëri financiare)
  - 4 janë auditime financiare
  - 3 janë auditime tematikë
  - 1 auditim performance
- **13** janë të përfunduar si proces auditimi në subjekt, por të paevaduar;
- **30** janë në proces auditimi.

Struktura e subjekteve të audituar e të evaduar, gjatë kësaj periudhe, jepet më analitikisht në formularin nr. 1, bashkëlidhur.

**Auditimet e përfunduar e të evaduar janë ushtruar në:**

• Ministritë dhe institucionet qendrore.....	13
• Institucionet e administratës së qeverisjes vendore dhe njësi të tjera në nivel vendor	15
• Drejtoritë dhe degët e tatimtaksave e të doganave.....	3
• Institucionet financiare dhe shoqëritë me kapital të përbashkët shtetëror.....	1
• Njësitë dhe projektet me financime të huaja.....	3
• Subjekte të mbrojtjes së mjedisit.....	1

Përveç auditimeve të mësipërme, gjatë kësaj periudhe, Kontrolli i Lartë të Shtetit ka trajtuar edhe 143 **letra dhe ankesa**, për probleme të ndryshme, nga të cilat 46 **rezultuan jashtë kompetencave dhe juridiksionit të institucionit**.


Nga 97 kërkesa dhe ankesa në kompetencë të KLSH, 47 prej tyre janë verifikuar dhe u është dhënë përgjigja përkatëse, ndërsa 50 janë në procesin e verifikimit.

Grafiku i mëposhtëm pasqyron fushat kryesore të shqetësimit publik të qytetarëve për çështje të qeverisjes në Shqipëri, nga të cilat 27 përqind e ankesave të adresuara KLSH<sup>së</sup> i



takojnë administrimit financiar dhe fushës së prokurimit publik; 34% privatizimit dhe kthimit të pronës; 2% taksa, tatime e dogana dhe 37% fushave të tjera

**Struktura e kerkesë-ankesave sipas fushave**



Struktura e ankesave dhe e kërkesave drejtuar KLSH<sup>së</sup> si edhe e shqyrtimit të tyre, jepet më analitikisht në formularin nr. 5, bashkëlidhur.

Nga auditimet e ushtruara gjatë kësaj periudhe janë zbuluar:

**A. Parregullsi dhe shkelje financiare, në të ardhurat dhe në shpenzimet e kryera, me dëm efektiv të përgjithshëm në shumën totale prej 1 801 271 000 lekë.**

**B. Shkelje të disiplinës financiare me ndikim negativ në performancën e subjekteve të audituara, në shumën e përgjithshme 1 113 163 000 lekë.**

Këto shkelje financiare me dëm efektiv dhe ndikim negativ në performancën e subjekteve të audituar i përkasin veprimtarisë ekonomiko-financiare për periudhën kohore 2011 - 2013, përcaktuar për çdo subjekt të audituar në programet e auditimit.

**A. SHKELJET ME DËM EKONOMIK JANË KONSTATUAR SI MË POSHTË:**

**1. NË FUSHËN E SHITJES DHE DHËNIES ME QIRA TË PASURISË SHTETËRORE, NË SHUMËN E PËRGJITHSHME PREJ 969 321 000 LEKË, KONSTATUAR NË:**

▪ Ministrinë e Energjetikës dhe Industrisë, Tiranë (mbi Konkensionet), në vlerën 955 661 000 lekë, nga të cilat:

a. *84 906 000 lekë si shumë e paarkëtuar nga mosushtrimi i penaliteteve nga Autoriteti Kontraktor për dorëzimin me vonesë të projektzbatimit të kontratave*



*koncesionare për faj të koncesionarit, në masën e përcaktuar në kontratë prej 0.005% të vlerës së investimit për çdo ditë vonesë,*

*b. 578 426 000 lekë si shumë e paarkëtuar nga mosushtrimi i penaliteteve nga Autoriteti Kontraktor për mosrealizimin në afat të investimeve të parashikuara në kontratat koncesionare, në masën e përcaktuar në kontratë prej 10% të vlerës së investimit të munguar,*

*c. 38 980 000 lekë si shumë e paarkëtuar nga mosushtrimi i penaliteteve nga Autoriteti Kontraktor për mosrealizim të prodhimit të parashikuara në kontratat koncesionare për periudhën janar 2011 deri më 31 dhjetor 2012 të 8 koncesionarëve, në masën e përcaktuar në kontratë prej 100% të vlerës së prodhimit të përcaktuar,*

*d. 717 000 lekë si shumë e paarkëtuar nga mospërlllogaritja nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore të tarifës së oponencës teknike mbi projektzbatimin e kontratave koncesionare,*

*e. 836 000 lekë si shumë e paarkëtuar nga përlllogaritja e gabuar nga Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore të tarifës së oponencës teknike mbi projektzbatimin e kontratave koncesionare,*

*f. 251 796 000 lekë si shumë e paarkëtuar nga mos përlllogaritja dhe mos kontabilizimi i detyrimeve të kontratave koncesionare në fushën e bakrit.*

▪ Universitetin Bujqësor, Tiranë, në vlerën 1 744 000 lekë, *nga moslllogaritja e sipërfaqes në ndërtesë dhe ajo funksionale si edhe nga moslllogaritja e trashësisë së mureve të objekteve në pronësi të vet, të dhëna me qira, në kundërshtim me VKM nr. 529, datë 08.06.2011, i ndryshuar.*

▪ Spitalin Universitar “Shefqet Ndroqi”, Tiranë, në vlerën 259 000 lekë, *si dëm ekonomik nga mosarkëtimi i detyrimeve kontraktore të qirasë për shfrytëzimin e taracës së godinës të spitalit në pronësi të vet.*

▪ Drejtorinë e Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit, Tiranë, në vlerën 183 000 lekë, *si të ardhura të munguara për buxhetin e shtetit, nga të cilat 123 000 lekë nga mosarkëtimi i vlerës 10% të garancisë së ofertës për subjektin fitues që nuk u paraqit për të*



*lidhur kontratën për shitjen skrap të 348 automjeteve të konfiskuara dhe 60 000 lekë si diferencë midis mjeteve të paraqitur në ankand dhe mjeteve të dorëzuar në fakt për skrap.*

▪ Bashkinë Shijak, në vlerën 11 474 000 lekë, *nga mosvjelja e detyrimeve kontraktore të qirasë për objektet e dhëna me qira.*

## 2. NË SEKTORIN E DOGANAVE, NË VLERËN E PËRGJITHSHME PREJ 146 678 000 LEKË, E KONSTATUAR NË:

▪ Degët e Doganave: Rinas dhe Fier, në vlerat respektive 2 531 000 lekë dhe 144 147 000 lekë, *nga mosllogaritja e mosarkëtim i detyrimeve doganore si rezultat i keqklasifikimit tarifor dhe pranimit të vlerës së transaktuar jashtë kriterëve dhe përcaktimeve ligjore.*

## 3. NË SEKTORIN E TATIMTAKSAVE, NË VLERËN E PËRGJITHSHME PREJ 38 193 000 LEKË, E KONSTATUAR NË:

▪ Projektin “Zhvillimi i rrugëve Bashkiake Tiranë”, në vlerën 7 550 000 lekë, *si pasojë e mosmbajtjes dhe mosderdhjes së tatimit në burim në masën 10%, për të ardhurat e përfituara.*

▪ Autoritetin e Aviacionit Civil, Tiranë, në vlerën 8 153 000 lekë, *nga mospagimi i taksës për çdo fluturim dhe biletë avioni.*

▪ Drejtorinë e Tatim - Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia, Tiranë, në vlerën 14 247 000 lekë, *si detyrime të papaguara të taksave vendore.*

▪ Këshillin e Qarkut, Dibër dhe Bashkitë: Rogozhinë, Shijak, Laç, Peqin si edhe Komunat: Shënkoll, Lezhë; Gjepalaj, Durrës; Tomin, Dibër; Pezë, Tiranë në vlerat respektive 708 000 lekë dhe 2 296 000 lekë, 2 217 000 lekë, 883 000 lekë, 25 000 lekë, si edhe 1 318 000 lekë; 579 000 lekë; 138 000 lekë; 79 000 lekë, *për mosvjelje të detyrimeve tatimore nga subjektet.*



**4. NË FUSHËN E PROKURIMEVE, NË VLERËN E PËRGJITHSHME PREJ 59 295 000  
LEKË, E KONSTATUAR NË:**

• Komunën Remas, Lushnjë.....	14 833 000 lekë
• Komunën Shënkoll, Lezhë.....	14 420 000 lekë
• Ish-Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit&Mbrojtjes Konsumatorit ...	12 945 000 lekë
• Projektin “Mbi menaxhimin e mbetjeve të ngurta të Tiranës”,DPUK	4 385 000 lekë
• Komunën Qendër, Mallakastër.....	3 737 000 lekë
• Universitetin Bujqësor, Tiranë.....	3 534 000 lekë
• Bashkinë Rrogozhinë.....	1 639 000 lekë
• Bashkinë Peqin.....	1 051 000 lekë
• Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivit të Shtetit, Tiranë.....	739 000 lekë
• Komunën Udenisht, Pogradec	516 000 lekë
• Bashkinë Shijak.....	399 000 lekë
• Projektin “Zhvillimi i rrugëve Bashkiake Tiranë”.....	390 000 lekë
• Autoritetin e Aviacionit Civil, Tiranë.....	300 000 lekë
• Bashkinë Laç.....	233 000 lekë
• Komunën Tomin, Dibër.....	174 000 lekë

**5. NË FUSHËN E SHPENZIMEVE OPERATIVE, NË SHUMËN E PËRGJITHSHME PREJ  
14 346 000 LEKË, E KONSTATUAR NË:**

• Drejtorinë e Tatim-Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia, Tiranë..	2 923 000 lekë
• Universitetin Politeknik, Tiranë.....	2 031 000 lekë
• Bashkinë Rrogozhinë.....	1 889 000 lekë
• Universitetin Bujqësor, Tiranë.....	1 775 000 lekë
• Degën e Doganës Fier.....	1 749 000 lekë
• Ish-Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit&Mbrojtjes Konsumatorit ....	865 000 lekë
• Komunën Shënkoll, Lezhë.....	655 000 lekë



PËRMBLEDHJA E AUDITIMEVE TË USHTRUARA GJATË  
4-MUJORIT TË PARË TË VITIT 2014



• Drejtorinë Rajonale Aluizni, Durrës.....	645 000 lekë
• Këshillin e Qarkut, Dibër.....	544 000 lekë
• Bashkië Peqin.....	244 000 lekë
• Komunën Qendër Çlirim, Fier.....	230 000 lekë
• Autoritetin Kombëtar i Ushqimit, Tiranë.....	216 000 lekë
• Projektin “Zhvillimi i rrugëve Bashkiake Tiranë”.....	207 000 lekë
• Bashkinë Laç.....	132 000 lekë
• Komunën Tomin, Dibër.....	180 000 lekë
• Spitalin Universitar “Shefqet Ndroqi”, Tiranë.....	61 000 lekë

**6. NË FUSHËN E URBANISTIKËS, NË SHUMËN E PËRGJITHSHME PREJ 6 855 000  
LEKË, E KONSTATUAR NË:**

▪ Komunat: Udenisht, Pogradec; Shënkoll, Lezhë dhe Këshillin e Qarkut, Dibër, në vlerat respektive 4 464 000 lekë, 2 373 000 lekë dhe 18 000 lekë, *nga moslogaritja dhe mosarkëtimi i taksës së ndikimit në infrastrukturë.*

**7. NË FUSHËN E SISTEMIT TË PAGAVE, NË SHUMËN E PËRGJITHSHME PREJ  
2 992 000 LEKË, E KONSTATUAR NË:**

▪ Drejtorinë Rajonale Aluizni, Durrës; Bashkitë: Peqin dhe Laç, si dhe Komunën Tomin, Dibër, në vlerat respektive 2 017 000 lekë; 585 000 lekë dhe 207 000 lekë, si dhe 183 000 lekë, *si përfitime pagesash të tepërta, në kundërshtim me dispozitat ligjore në fuqi.*

**8. NË FUSHËN E SHPËRBLIMEVE, NË SHUMËN E PËRGJITHSHME PREJ 1 417 000  
LEKË, E KONSTATUAR NË:**

▪ Universitetin Bujqësor, Tiranë, në vlerën 1 417 000 lekë, *si shpërblim i padrejtë nga administrata e Rektoratit të UBT për punonjësit e vet në dy raste (641 000 lekë në vitin 2012 dhe 776 000 lekë në vitin 2013), në kundërshtim me VKM nr. 418, datë 27.06.2012.*



**9. NË MUNGESË MATERIALE, NË SHUMËN E PËRGJITHSHME PREJ 2 922 000 LEKË,  
E KONSTATUAR NË:**

▪ Drejtorinë e Përgjithshme të Arkivit të Shtetit, Tiranë; Drejtorinë e Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit, Tiranë dhe Autoritetin e Aviacionit Civil, Tiranë, në vlerat respektive 1 678 000 lekë, 700 000 lekë dhe 544 000 lekë, *si mungesë materiale në inventar.*

**10. NË ZËRIN “TË TJERA”, SHKELJE TË DISIPLINËS FINANCIARE NË SHUMËN E  
PËRGJITHSHME PREJ 559 252 000 LEKË, QË I PËRKASIN:**

▪ Projektit “Mbi menaxhimin e mbetjeve të ngurta të Tiranës”, DPUK Tiranë, në vlerën 47 983 000 lekë, *si përfitime të padrejta për punime të pakryera, ku janë raportuar volume më të mëdha se ato të kryera në fakt.*

▪ Universitetit Bujqësor, Tiranë, në vlerën prej 5 421 000 lekë, *nga mosllogaritja dhe mosderdhja e kontributit të sigurimeve shoqërore deri në kufirin e lejuar për 88 punonjës të punësuar në dy vende pune (si diferencë e ndalesës së kryer pranë qendrës së parë të punës dhe kufirit maksimal).*

▪ Muzeut “Gjergj Kastrioti Skënderbeu”, Krujë, në vlerën 105 000 lekë, *si dëm ekonomik për buxhetin e shtetit nga moskontabilizimi dhe mosderdhja në bankë të të ardhurave të realizuara nga shitja e biletave.*

▪ Drejtorisë Rajonale Aluizni-t, Elbasan 1, në vlerën 412 633 000 lekë, *si dëm ekonomik nga llogaritja e pasaktë e vlerave të parcelave ndërtimore.*

▪ Drejtorisë Rajonale Aluizni-t, Durrës, në vlerën 93 110 000 lekë, *si dëm ekonomik nga llogaritja më pak e sipërfaqes së trullit, në kundërshtim me VKM përkatës.*



**B. SHKELJE TË DISIPLINËS FINANCIARE ME NDIKIM NEGATIV NË PERFORMANCËN  
E SUBJEKTEVE TË AUDITUARA, NË SHUMËN E PËRGJITHSHME 1 113 163 000  
LEKË DHE KONKRETISHT NË:**

▪ Ish-Ministrinë e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, në vlerën totale prej 92 092 000 lekë, *nga të cilat 15 122 000 lekë nga rritja artificiale e vlerës së projekteve me të tretët në Qendrën e Transferimit të Teknologjisë Bujqësore për dy raste; 2 126 000 lekë nga pagesa për largimet e padrejta nga puna për 6 raste dhe 74 844 000 lekë nga moskontabilizimi dhe mosarkëtimi i qirave të ambjenteve të dhëna me qira për vitet 2012-2013.*

▪ Ministrinë e Energjetikës & Industrisë, Tiranë (Koncensionet) në vlerën totale 947 196 000 lekë, *nga të cilat 387 196 000 lekë nga mosarkëtimi nga shoqëritë e sigurimeve të garancisë së kontratave për koncensionarët që nuk kanë zbatuar kontratat dhe 560 000 000 lekë nga mosarkëtimi i garancisë së kontratës në formë depozite bankare nga shoqëria "BIG SPA".*

▪ Spitalin Universitar "Shefqet Ndroqi", Tiranë në vlerën 1 716 000 lekë, *nga përdorimi jo efektiv i një fondi në fushën e prokurimeve.*

▪ Universitetin Politeknik, Tiranë, në vlerën 11 471 000 lekë, *nga të cilat 4 922 000 lekë si pagesa pa miratim të MASH për petagogë të brendshëm që japin mësim në ciklin e ulët, si dhe 6 549 000 lekë nga mosaplikimi i 20% tvsh për shpërblimet e dhëna për shërbimin e oponentëve konform ligjit nr. 7928, dt 27.04.1995 "Për TVSH", i ndryshuar.*

▪ Drejtorinë e Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit, Tiranë, në vlerën 60 688 000 lekë, *si mungesë të ardhurash për institucionin nga të cilat 46 428 000 lekë nga ndryshimi i tarifave të dhënies me qira të depozitave të karburantit dhe 14 260 000 lekë nga ndryshimi i tarifave të dhënies me qira të magazinave, në kundërshti me VKM përkatës.*

\*

\*

\*

PËRMBLEDHJA E AUDITIMEVE TË USHTRUARA GJATË  
4-MUJORIT TË PARË TË VITIT 2014



Për parregullsitë dhe shkeljet financiare me dëm ekonomik në të ardhurat dhe në shpenzimet e kryera, të pasqyruara në raportet e auditimit të evaduar gjatë kësaj periudhe, ***në shumën e përgjithshme prej 1 801 271 000 lekë, KLSH ka rekomanduar zhdëmtimin e dëmit të shkaktuar në masën 100% të tij.***

Më analitikisht, struktura e zbulimeve nga auditimet e ushtruara paraqitet në formularin nr. 2, bashkëlidhur.

Për të metat dhe shkeljet e konstatuara për çdo subjekt të kontrolluar, në bazë të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 “Për Kontrollin e Lartë të Shtetit”, ndryshuar me ligjin nr. 8599, datë 01.06.2000, KLSH ka lënë detyra për zbatim, duke njoftuar edhe institucionet apo strukturat përkatëse, si dhe ka bërë publike rezultatet e auditimeve në median e shkruar dhe atë elektronike.

Gjithashtu, për shkeljet e konstatuara në bazë të ligjit të mësipërm, ligjit nr. 8549, datë 11.11.1999 “Statusi i nëpunësit civil” dhe disa ligjeve të tjera në fuqi, KLSH u ka kërkuar organeve respektive shqyrtimin dhe marrjen e 290 *masave disiplinore dhe administrative*, lloji dhe zbatimi i të cilave, sipas njoftimeve zyrtare me shkrim nga organet përkatëse dhe rikontrollit të zbatimit të rekomandimeve në subjektet e audituara, paraqitet si vijon:

Nr.	Lloji i masës	Propozuar Gjithsej	Gjendja aktuale e zbatimit		
			Të zbatuara	Pa përgjigje	% realizimit
1	“Vërejtje me shkrim”	71	51	20	71.8
2	“Vërejtje me paralajmërim”	120	71	49	59.1
3	“Pezullim ngritje në detyrë”	-	-	-	-
4	“Kalim në një nivel më të ulët”	7	3	4	42.8
5	“Largim nga shërbimi civil”	1	-	1	-
6	“Largim nga detyra”	3	2	1	66.6
7	“Largim nga puna”	45	7	38	15.5
8	Masa administrative (gjoba)	36	7	29	19.4
9	Në kompetencë të APP-së	7	6	1	85.7
	<b>Shuma</b>	<b>290</b>	<b>147</b>	<b>143</b>	<b>50.6</b>

Në bazë të ligjit për KLSH-në, për masat e kërkuara dhe llojin e tyre është njoftuar dhe Departamenti i Administratës Publike, Tiranë.



Gjatë kësaj periudhe, nga ana e KLSH-së janë bërë *8 kallëzime penale*, e konkretisht për:

- Drejtorinë Rajonale ALUIZNI-t, Tiranë
- Drejtorinë Rajonale ALUIZNI-t, Elbasan 1
- Drejtorinë Rajonale ALUIZNI-t, Durrës
- Komunën Qendër, Mallakastër
- Komunën Remas, Lushnjë
- Komunën Udenisht, Pogradec
- Komunën Shënkoll, Lezhë
- ZVRPP, Tiranë

Të 8 kallëzimet penale janë në hetim dhe janë pasqyruar në mënyrë më të detajuar në formularin nr. 4, bashkëlidhur.

**KONTROLLI I LARTË I SHTETIT**



## STATISTIKAT

Evidenca e emërtimit të subjekteve të audituara nga KLSH, për të cilët janë evaduar rezultatet e auditimit.....	Formulari 1
Evidenca përmbledhëse e shkeljeve me dëm ekonomik të konstatuara gjatë auditimeve të ushtruar për të ardhurat dhe shpenzimet.....	Formulari 2
Evidenca e masave disiplinore dhe administrative të rekomanduara dhe zbatimi i tyre.....	Formulari 3
Evidenca e kallëzimeve penale të KLSH.....	Formulari 4
Evidenca e shqyrtimit të ankesave dhe kërkesave drejtuar KLSH.....	Formulari 5

**EMËRTIMI I SUBJEKTEVE TË AUDITUAR NGA KLSH, PËR TË CILËT JANË  
EVADUAR REZULTATET E AUDITIMIT GJATË PERIUDHËS JANAR-PRILL -2014**

**I. DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË BUXHETIT QENDROR, ADMINISTRATËS SË  
LARTË PUBLIKE, MENAXHIMIT FINANCIAR DHE AUDITIMIT TË BRENDSHËM**

1. Ish-Ministria e Bujqësisë, Ushqimit&Mbrojtjes Konsumatorit (MBZHR&AU), Tiranë
2. Ministria e Energjetikës & Industrisë, Tiranë (Koncensionet)
3. Drejtoria e Përgjithshme e Arkivit të Shtetit, Tiranë
4. Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit, Tiranë
5. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit, Tiranë
6. Universiteti Politeknik, Tiranë
7. Universiteti Bujqësor, Tiranë
8. Shkolla e Magjistraturës, Tiranë
9. Spitali Universitar "Shefqet Ndroqi", Tiranë
10. Arkivi Shtetëror Vendor, Durrës
11. Muzeu "Gjergj Kastrioti Skënderbeu", Krujë
12. Komuna Qendër, Mallakastër

**II. DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË BUXHETIT TË PUSHTETIT VENDOR,  
KONTROLLIT TË TERRITORIT, ADMINISTRIMIT DHE PRIVATIZIMIT TË PRONËS  
SHTETËRORE**

1. Bashkia Rrogozhinë
2. Bashkia Peqin
3. Bashkia Laç
4. Bashkia Shijak
5. Komuna Tomin, Dibër
6. Komuna Qendër Çlirim, Fier
7. Komuna Pezë, Tiranë
8. Komuna Gjepalaj, Durrës
9. Komuna Shënkoll, Lezhë

10. Komuna Remas, Lushnjë
11. Komuna Udenisht, Pogradec
12. Këshilli i Qarkut, Dibër
13. Drejtoria Rajonale ALUIZNI, Durrës
14. Drejtoria Rajonale ALUIZNI, Elbasan 1
15. ZVRPP, Tiranë

### **III. DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË INVESTIMEVE DHE PROJEKTEVE ME FINANCIME TË HUAJA, SHOQËRIVE PUBLIKE DHE MBROJTJES SË MJEDISIT**

1. Projekti "Zhvillimi i rrugëve Bashkiake Tiranë", Bashkia Tiranë
2. Projekti "Mbi menaxhimin e mbetjeve të ngurta të Tiranës", DPUK Tiranë
3. Projekti "Modernizimi i Asistencës Sociale", Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë
4. Autoriteti i Aviacionit Civil, Tiranë
5. Agjencia Rajonale e Mjedisit, Qarku Durrës

### **IV. DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË TË ARDHURAVE TË BUXHETIT TË SHTETIT**

1. Drejtoria e Tatim-Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia, Tiranë
2. Dega e Doganës Rinas
3. Dega e Doganës Fier

### **V. DEPARTAMENTI I AUDITIMIT TË PERFORMANCËS**

1. Instituti i Statistikës, Tiranë "Censusi 2011"



## Formulari 2

**EVIDENCA PËRMBLEDHËSE E SHKELJEVE ME DËM EKONOMIK TË KONSTATUAR GJATË AUDITIMEVE TË USHTRUARA  
PËR TË ARDHURAT DHE SHPENZIMET, GJATË 4-MUJORIT TË PARË - 2014**

Njësia në 000/lekë

Nr.	EMERTIMI I SUBJEKTEVE	SHKELJE TË LIGJSHMËRISË ME EFEKTE FINANCIARE (DËM EKONOMIK)											Gjithsej	Rekomand. për zhdëmtim
		Në sektorin e tatim- taksave	Në sektorin e doganave	Nga dividenti	Nga shitja e dhënia me qira e pasurisë	Në sistemin e pagave	Në fushën e shpërb.	Në shpenz. operative	Në fushën e urbanistikës	Në fushën e prokurimeve	Në mungesë materiali e inventari	Të tjera		
a	b	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13
1	Ish-MBU&MK, Tiranë							865		12 945			13 810	13 810
2	Ministria e Energjetikës & Industrisë (mbi koncensionet)				955 661								955 661	955 661
3	DP Arkivit të Shtetit									739	1 678		2 417	2 417
4	Autoriteti Kombëtar i Ushqimit							216					216	216
5	Komuna Qendër, Mallakastër									3 737			3 737	3 737
6	Universiteti Bujqësor, Tiranë				1 744		1 417	1 775		3 534		5 421	13 891	13 891
7	Spitali "Shefqet Ndroqi", Tiranë				259			61					320	320
8	Universiteti Politeknik, Tiranë							2 031					2 031	2 031
9	Muzeu "Gjergj Kastrioti Skënderbeu", Krujë											105	105	105
10	Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit				183						700		883	883
11	Bashkia Rrogozhinë	2 296						1 889		1 639			5 824	5 824
12	Bashkia Laç	883				207		132		233			1 455	1 455

Njësia në 000/lekë

Nr.	EMERTIMI I SUBJEKTEVE	SHKELJE TË LIGJSHMËRISE ME EFEKTE FINANCIARE (DËM EKONOMIK)											Gjithsej	Rekomand. për zhdëmtim
		Në sektorin e tatim - taksave	Në sektorin e doganave	Nga dividenti	Nga shitja e dhënia me qira e pasurisë	Në sistemin e pagave	Në fushën e shpërb.	Në shpenzimet operative	Në fushën e urbanistikës	Në fushën e prokurimeve	Në mungesë materiali e inventari	Të tjera		
a	b	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13
13	Bashkia Shijak	2 217			11 474					399			14 090	14 090
14	Bashkia Peqin	25				585		244		1 051			1 905	1 905
15	Komuna Pezë, Tiranë	79											79	79
16	Komuna Gjepalaj, Durrës	579											579	579
17	Komuna Shënkoll, Lezhë	1 318						655	2 373	14 420			18 766	18 766
18	Komuna Remas, Lushnje									14 833			14 833	14 833
19	Komuna Qendër Çlirim, Fier							230					230	230
20	Komuna Tomin, Dibër	138				183		180		174			675	675
21	Komuna Udenisht, Pogradec								4 464	516			4 980	4 980
22	Këshilli i Qarkut, Dibër	708						544	18				1 270	1 270
23	Aluizni Rajonal, Elbasan 1											412 633	412 633	412 633
24	Aluizni Rajonal, Durrës					2 017		645				93 110	95 772	95 772
25	Projekti "Zhvillimi i rrugëve Bashkiake Tiranë"	7 550						207		390			8 147	8 147
26	Projekti "Mbi menaxhimin e mbetjeve të ngurta të Tiranës", DPUK Tiranë									4 385		47 983	52 368	52 368
27	Autoriteti Aviacionit Civil, Tiranë	8 153								300	544		8 997	8 997

Njësia në 000/lekë

Nr.	EMERTIMI I SUBJEKTEVE	SHKELJE TË LIGJSHMËRISE ME EFEKTE FINANCIARE (DËM EKONOMIK)											Gjithsej	Rekomand. për zhdëmtim
		Në sektorin e tatim - taksave	Në sektorin e doganave	Nga dividenti	Nga shitja e dhënia me qira e pasurisë	Në sistemin e pagave	Në fushën e shpërb.	Në shpenzimet operative	Në fushën e urbanistikës	Në fushën e prokurimeve	Në mungesë materiali e inventari	Të tjera		
a	b	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11	12	13
28	Drejtoria e Tatim-Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Tiranë	14 247						2 923					17 170	17 170
29	Degën e Doganës Rinas		2 531										2 531	2 531
30	Degën e Doganës Fier		144 147					1 749					145 896	145 896
<b>Totali</b>		38 193	146 678		969 321	2 992	1 417	14 346	6 855	59 295	2 922	559 252	1 801 271	1 801 271





Nr.	EMERTIMI	Vërejtje me shkrim		Vërejtje me paralajm.		Pezullim ngritje në detyrë		Kalim në një nivel më të ulët		Largim nga shërbimi civil		Largim nga detyra		Largim nga puna		Masa administrati		Kopetenc APP		Gjithsej	
		Rek.	Zbat.	Rek.	Zbat.	Rek.	Zbat.	Rek.	Zbat.	Rek.	Zbat.	Rek.	Zbat.	Rek.	Zbat.	Rek.	Zbat.	Rek.	Zbat.	Rek.	Zbat.
18	Komuna Udenisht, Pogradec	1																		1	
19	Këshilli i Qarkut, Dibër	2	2	2	2															4	4
20	Aluizni Rajonal, Elbasan 1			3									7							10	
21	Aluizni Rajonal, Durrës			3									7							10	
22	ZVRPP, Tiranë			25	25								3							28	25
23	Drejtoria Qendër, Aluizni, Tiranë			5																5	
24	Projekti "Zhvillimi i rrugëve Bashkiake Tiranë", Bashkia Tiranë,			1								3	2							4	2
25	Projekti "Mbi menaxhimin e mbetjeve të ngurta të Tiranës",DPUK Tiranë			1																1	
26	Agjencia Rajonale e Mjedisit, Durrës			5	5															5	5
27	Autoriteti i Aviacionit Civil, Tiranë			12	12								2	2						14	14
28	Drejtoria Tatim-Taksave dhe Tarifave Vendore, Bashkia Tiranë	34	34										2	2	5					41	36
29	Degën e Doganës Rinas			3											8					11	
	Degën e Doganës Fier			1	1			3	3						2	2				6	6
	<b>Totali</b>	71	51	120	71			7	3	1		3	2	45	7	36	7	7	6	290	147

**EVIDENCA E KALLËZIMEVE PENALE TË DËRGUARA NGA KONTROLLI I LARTË I SHTETIT,  
PËR PERIUDHËN JANAR-PRILL – 2014**

Nr.	Subjekti ndaj të cilit është bërë kallëzimi	Nr. prot. , data e kallëzimit	Numri i personave të kallëzuar, cilësimi i veprës	Dëmi i shkaktuar në 000/lekë	Gjendja e kallëzimit	Departamenti që ka konstatuar veprën penale
1	Komuna Qendër, Mallakastër	Nr.868/8 dt.11.04.2014	3 persona për shpërdorim detyre, neni 248 i kodit penal	3 737	Në hetim	Departamenti i Auditimit të Buxhetit Qendror, Administratës së Lartë Publike, Menaxhimit Financiar dhe Auditimit të Brendshëm
2	Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t, Tiranë	Nr.577/24 dt.20.02.2014	3 persona për shpërdorim detyre, neni 248 i kodit penal	2 129	Në hetim	Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, Kontrollit të Territorit, Administrimit të Aseteve të Qendrueshme
3	Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t, Elbasan 1	Nr.804/12 dt.20.02.2014	10 persona për shpërdorim detyre, neni 248 i kodit penal	-	Në hetim	

Nr.	Subjekti ndaj të cilit është bërë kallëzimi	Nr. prot. , data e kallëzimit	Numri i personave të kallëzuar , cilësimi i veprës	Dëmi i shkaktuar në 000/lekë	Gjendja e kallëzimit	Departamenti që ka konstatuar veprën penale
4	Drejtoria Rajonale e ALUIZNI-t, Durrës	Nr.805/18 dt.14.04.2014	7 persona për shpërdorim detyre, neni 248 i kodit penal	95 772	Në hetim	Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, Kontrollit të Territorit, Administrimit të Aseteve të Qendrushme
5	ZVRPP Tiranë	Nr. 577/23 dt.19.02.2014	3 persona për shpërdorim detyre, neni 248 i kodit penal	-	Në hetim	
6	Komuna Remas, Lushnjë	Nr. 1078/12 dt.19.02.2014	3 persona për shpërdorim detyre dhe për shkelje të pabarazisë së pjesëmarrësve në tendera apo ankande publike, neni 248 dhe 258 i kodit penal	14 833	Në hetim	
7	Komuna Udenisht, Pogradec	Nr. 225/12 dt.18.04.2014	3 persona për shpërdorim detyre, neni 248 i kodit penal	-	Në hetim	
8	Komuna Shënkoll, Lezhë	Nr. 1079/9 dt.23.04.2014	2 persona për shpërdorim detyre, neni 248 i kodit penal	12 514	Në hetim	
<b>8 Gjithsej kallëzime penale</b>		-	<b>Për 34 persona</b>	<b>128 985</b>		-



EVIDENCA E SHOYRTIMIT TË ANKESAVE DHE KËRKESAVE DREJTUAR KONTROLLIT TË LARTË TË SHTETIT,  
PËR PERIUDHEN JANAR-PRILL - 2014

KLASIFIKIMI DHE MENYRA E ZGJIDHJES SË TYRE																				
Nr. gjithsej	Për administrim financiar dhe prokurime					Privatizim e kthim prone					Taksa, tatime e dogana				Të tjera					
	Nr.	Verifikuar e rezultuar		Vazhdon verifikimi	Ardhur jashtë kompetencave të KLSH (nuk verifikohet)	Nr.	Verifikuar e rezultuar		Vazhdon verifikimi	Ardhur jashtë kompetencave të KLSH (nuk verifikohet)	Nr.	Verifikuar e rezultuar		Vazhdon verifikimi	Ardhur jashtë kompetencave të KLSH (nuk verifikohet)	Nr.	Verifikuar e rezultuar		Vazhdon verifikimi	Ardhur jashtë kompetencave të KLSH (nuk verifikohet)
		E drejtë	Pa drejtë				E drejtë	Pa drejtë				E drejtë	Pa drejtë				E drejtë	Pa drejtë		
143	39	9	10	19	1	48	4	4	30	10	3	1			2	53	4	15	1	33



## FJALORI I SHKURTIMEVE

ALUIZNI	Agjencia e Legalizimit, Urbanizimit dhe Integrimit të Zonave/Ndërtimeve Informale
AKU	Autoriteti Kombëtar i Ushqimit
AAC	Autoriteti i Aviacionit Civil
ARM	Agjencia Rajonale e Mjedisit
APP	Agjencia e Prokurimit Publik
AP	Avokati i Prokurimeve
DPUK	Drejtoria e Përgjithshme e Ujësjiellës Kanalizime
DPRMSH	Drejtoria e Përgjithshme e Rezervave Materiale të Shtetit
INSTAT	Instituti i Statistikës
KM	Këshilli i Ministrave
KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
MMSR	Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë
MBU&MK	Ministria e Bujqësisë, Ushqimit&Mbrojtjes Konsumatorit
MBZHR&AU	Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave
MEI	Ministria e Energjetikës & Industrisë, Tiranë
QTTB	Qendra e Transferimit të Teknologjisë Bujqësore
SHA	Shoqëri aksionere
T.v.sh.	Tatimi mbi vlerën e shtuar
UMF	Udhëzimi i Ministrisë së Financave
ZVRPP	Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme





**KLSH**

1925